



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.8712/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, gjykatësi individual Dr.sc. Rafet Haxhaj, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen përmbartimore të kreditorit Xh. B nga Prizreni, të cilin e përfaqëson S. K avokat në Prishtinë, kundër debitorit Spitali i Përgjithshëm, “Prim Dr.Daut Mustafa” në Prizren, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, PPP.nr.776/20 të datës 12.10.2021, me datë 30.12.2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar, ankesa e debitorit Spitali i Përgjithshëm “Prim Dr.Daut Mustafa” në Prizren, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren, PPP.nr.776/20 i datës 12.10.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I., te dispozitivit refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit të Spitali i Përgjithshëm, “Prim Dr.Daut Mustafa” në Prizren i ushtruar kundër Urdhrit për përmbartim, P.nr.2535/20 të dt.16.07.2020 të përmbartuesit privat A. M nga Vushtrria dhe i njëjti Urdhër për përmbartim, mbetet në fuqi. Në pikën II., të dispozitivit, secila palë i bartë shpenzimet e përmbartimit në këtë çështje juridike të përmbartimit përveç se deri në përfundimin e procedurës në këtë çështje juridike të përmbartimit, të gjitha shpenzimet e përmbartimit, do t'i bartë ajo palë e cila e humb procesin gjyqësor-përmbartimor.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur debitori për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurit Spitali i Përgjithshëm Prim Dr.Daut Mustafa në Prizren si e bazuar dhe prishet aktvendimi i

atakuar dhe të kthej të njëjtën në rigjykim dhe rivendosje ose të njëjtin ta ndryshoj dhe ta refuzojë si të pa bazë.

Gjykata e Apelit e Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se kreditori ka parashtruar propozim për lejimin e përmbarimit me datë 17.07.2020 te Përmbaruesi A. M i cili ka caktuar Urdhrin Përmbarimor, në bazë të dokumentit përmbarimor-Vendimit të Inspektoratit të Punës Nr.692/2020 të datës 14.05.2020, me të cilin vendim është detyruar që debitori t'ia paguaj kreditorit borxhin në shumë prej 1,524.88€ në emër të kompensimit të dy pagave jubilarë.

Përmbaruesi Privat në territorin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit ka nxjerr urdhër P.nr.2535/20 të dt.17.07.2020 me të cilin ka caktuar përmbarimin në bazë të vendimit të Vendimit të Inspektoratit të Punës Nr.692/2020 të datës 14.05.2020, i cili përbënë dokument përmbarues konform dispozitave të nenit 21, 22 dhe 24 par.3 dhe 5 i LPP-së.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, debitori me datë 27.07.2020 brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim debitori. Në prapësim debitori ka theksuar se urdhri në fjalë është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore ndaj debitorit Spitali i Përgjithshëm "Prim Dr.Daut Mustafa" në Prizren, me propozim që të aprovet prapësimi i tij dhe të shfuqizohet propozimi i kreditorit për fillimin e procedurës së ekzekutimit ndaj debitorit dhe të refuzohen shpenzimet e lejimit të cekura nga përmbaruesi.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit duke i propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar, të vërtetohet Urdhri Përmbarimor P.nr.2535/20 të datës 17.07.2020 i përmbaruesit privat Atip Mustafa dhe të detyrohet debitori që t'ia paguaj borxhin kreditorit dhe shpenzimet procedurale.

Gjyqtari i vetëm i gjykatës së shkallës së dytë ka akceptuar në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë për faktin se nuk është gjetur shkelje e dispozitave procedurale duke pasur parasysh se Propozimi për përmbarim bazohet në dokumentin përmbarues dhe në dokumentin e besueshëm, respektivisht Neni 21 i LPP-së, i cili citohet si vijon: "*Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*". Më tutje në Nenin 22 paragrafi 1, pika 1.2 përcaktohet se: "*Dokumente përmbaruese janë: vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative*

dhe akt pajtimi (më tej: ujdia)". Në ndërlidhje me këtë nen është edhe Neni 23, paragrafi 2 "Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike, kurse akt pajtim administrativ konsiderohet ujdia e arritur në procedurën administrative përpara organit ose shërbimit, përkatësisht personit juridik të tillë, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër". Poashtu në mbështetje të këtij arsytimi të dispozitivit është edhe Neni 1 paragrafi 2: "Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për përmbarrimin e vendimit të marrë në procedurën administrative dhe për kundërvajtje me të cilin është caktuar detyrimi në të holla, përveçse kur për përmbarrimin e tillë është paraparë me ligj kompetenca e organit tjetër".

Gjithashtu edhe Neni 24 paragrafi 3, i cili përcakton se "Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarrimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë".

Gjyqtari i i vetëm gjen se pretendimet e debitorit lidhur me Vendimin e Inspektoratit të Punës se i njëjti është lëshuar pa u vërtetuar gjendja faktike dhe erdhi në përfundim se një pretendim i tillë është pa mbështetje ligjore, ngase në procedurën përmbarrimore vlen i ashtuquajtur **Parimi i legalitetit rigoroz formal**, si parim i veçant i procedurës përmbarrimore, i cili ka të bëjë me rregullat e nxjerrjes së aktvendimit mbi lejimin e ekzekutimit dhe sipas të cilit gjykata e ekzekutimit nuk ka tagër të lëshohet në vlerësimin e ligjshmërisë materiale të vendimit apo të përmbajtjes së tij dhe të rregullsisë së dokumentit, por vetëm shqyrtohen elementet formale të dokumentit në bazë të cilit ëshë lejuar përmbarrimi si dhe përshtatshmërisë së vendimit që është objekt i përmbarrimit. Sipas këtij parimi ekzistimi i kredisë dhe legjitimitimi i palëve mund të provohet vetëm me anë të dokumentit të provuar.

Gjyqtari i i vetëm, ndër të tjera konstaton se në këtë procedurë gjykata e shkallës së parë gjatë vendosjes në rastin konkret nuk ka tagër të vendos lidhur me rregullsinë në aspektin përmbajtësor të një akti administrativ siç është Vendimi i Inspektoratit të Punës Nr.692/2020 i datës 14.05.2020, dhe se vlerësimin e tillë pala e pakënaqur është dashur ta kërkoj në procedurë administrative respektivisht të iniciojë konfliktin administrativ duke u mbështetur në kushtet ligjore të parapara me Ligjin për Procedurën Administrative dhe Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjyqtari i i vetëm i Gjykatës së Apelit vlerëson se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete për një vendosje të këtillë bazuar në dispozitat përkatëse ligjore që i referohen kësaj çështje përmbarrimore.

Për këto arsye gjyqtari i vetëm i Gjykatës së Apelit ka vendosur që pretendimet ankimore të refuzohen në tërësi si të pabazuara dhe që aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjykatësit individual në shkallë të dytë bazohet edhe në dispozitën e nenit 3 par.2. të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerrë gjykatësi individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 par.1 pik b) të LPK-së lidhur me nenin 17 dhe 3.2 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.8712/2021, me datë 30.12.2021

GJYKATËSI
Dr.sc. Rafet Haxhaj